



REPUBLICA E KOSOVËS  
KOMUNA E MALISHEVËS  
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

PRANUAR NË:

ACCEPTED ON:

PRILUJENË:

Nr.No.Br.

12.06.18

12/8



Në mbështetje të nenit 68 paragrafi 68.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28, nenit 12 dhe 22 të Rregullorës së MF, nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, **Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në komunën e Malishevës në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit të komunës, bëjnë:**

### THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Ftohen organizatat joqeveritare të sferës së kulturës, rinisë dhe sportit që janë aktive dhe zhvillojnë aktivitetet e tyre në komunën e Malishevës, se mund të aplikojnë me projektet e tyre për përkrahje financiare nga Komuna e Malishevës për vitin 2018.

Dokumentet e kërkuara për aplikim:

1. Projektpropozimi
2. Aplikacioni
3. Dokumenti identifikues
4. Certifikata e vendbanimit (për persona fizik)
5. Certifikata e regjistrimit (për persona juridik)
6. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë (për persona fizik)
7. Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së (për persona juridik)
8. Konfirmimin nga banka për xhironlogarinë e aplikuesit

### Subvencionet për aktivitete kulturore, rinore dhe sportive

Komuna do të ndajë subvencione për kulturë, rini dhe sport duke përfshirë:

1. Klubet sportive (pagesa e regjistrimit të klubeve në federatat përkatëse, pagesa e kuotizimit, referimit, transportit dhe ushqimit për ndeshjet zyrtare)
2. Garat sportive
3. Botimi i librave
4. Karnevali për fëmijë
5. Shënimi i Ditës së Çlirimit dhe Dëshmorëve të Komunës së Malishevës
6. Panairi Artizanal

7. Shfaqje teatrale për fëmijë
8. Ekspozitë artistike
9. Shkolla rinore verore
10. Kolonia e artistëve të rinj
11. Dita e Rinisë
12. Festivali Folklorik “Oda e Llapushës”- edicioni i pestë
13. Edukim joformal ( kurse: gjuhë angleze, matematikë, pikturë dhe kompjuter )

Mbështetja financiare do të ofrohet varësisht nga vlerësimi i projektiti nga Komisioni dhe mundësitë buxhetore të Komunës.

Tërheqja dhe dorëzimi i aplikacioneve mund të bëhet në ndërtesën e Komunës, kati I, në Qendrën për Shërbime për Qytetarët.

Aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në zarf të mbyllur, ku brenda zarfit vendoset një kopje e printuar e të gjithë dokumentacionit original të kërkuar.

Aplikuesit mund ta dorëzojnë dokumentacionin brenda afatit prej 15 ditë pune nga dita e shpalljes në uebfaqen e Komunës.

**Malishevë, më 12.04.2018**

**Drejtoresha e DKRS-së**  
**Besartë Kryeziu – Ramaj**  
  
